



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:282505
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05488962

AC.nr.1335/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve N. G., A. G., S. G. dhe R. G., që të gjithë nga fshati M., komuna e Prishtinës, të cilët i përfaqëson H. M. avokat në Prishtinë, kundër të paditurës komuna e Prishtinës të cilën sipas autorizimit e përfaqëson J. I. nga “Avokatura I.” sh.p.k, me seli në Prishtinë, për shkak të vërtetimit të pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së paditësve, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.3438/2004, i datës 15.12.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e paditësve N. G., A. G., S. G. dhe R. G., që të gjithë nga fshati Matičan, komuna e Prishtinës, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.3438/2004, i datës 15.12.2021 dhe çështja kthehet në rigjykim dhe rivendosje të njëjtës gjykatë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin C.nr.3438/2004, i datës 15.12.2021, ka vendosur: I.REFUZOHET - kërkesëpadia e paditësve N. G., A. G., M. G. dhe S. e R. G. të gjithë nga fshati M., me të cilën kanë kërkuar: të Vërtetohet se të njëjtët janë bashkëpronar faktik dhe juridik të paluajtshmërisë secili për pjesën përballë truallit të vet në M. në vendin e quajtur “fshat” në ngastrat kadastrale: nr. ...-3, në sipërfaqe S=0....00 ha apo S=... m2 dhe sipërfaqen e ngastrës kad. nr. ...-2, S=0....02 ha e që sipërfaqja e përgjithshme është S=0.....01 ha, ngastra kad. Nr. 484-0 në sipërfaqe prej S=0.....01 ha;

-Kërkesëpadia e paditësit N. G., si trashëgimtar i S. G. për ng. kad. nr. 1...-1, lloji i njësisë: parcelë lloji i pronës: shoqërore, zona rurale (R), lloji i shfrytëzimit të parcelës, bujqësore, shfrytëzimi aktual i parcelës: kullosë, klasa e kualitetit, kullosë e klasës pestë (5), sipërfaqja S=... m) e cila gjendet në vendin e quajtur “M. Z.”, e evidentuar në Certifikatën me njësi kadastrale P-....-0...-.. Z. Kad. M..;

-1376-3, lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: shoqërore zona: rurale (R), lloji i shfrytëzimit të parcelës bujqësore, shfrytëzimi aktual i parcelës, kullosë, klasa e kualitetit: kullosë e klasës pestë (5), sipërfaqja S= ... m², e cila gjendet në vendin e quajtur “M. Z.”, e evidentuar në Certifikatën me njësi kadastrale P- 7....-...-..., Z. Kad. M..., të cilat evidentohen me pjesë të pronës 1/1: Komuna e Prishtinës – e drejta e shfrytëzimit me kohë të caktuar: “H..”, Sh. A Prishtinë;

...-2, lloji njësisë: parcelë, lloji i pronës shoqërore, zona: rurale (R), lloji i shfrytëzimit të parcelës: bujqësore, shfrytëzimi aktual i parcelës: kullosë, klasa i kualitetit: kullose e klasës pestë (5), sipërfaqja S=.... m², e cila gjendet në vendin e quajtur “M. Z.”, e evidentuar në Certifikatën me njësi kadastrale P-....-0....-2, Z. Kad. M... dhe

-1376-4 lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: shoqërore, zona, rurale (R) lloji i shfrytëzimit të parcelës, bujqësore, shfrytëzimi aktual i parcelës: kullosë, klasa e kualitetit, kullosë e klasës së pestë (5), sipërfaqja S=7266 m², e cila gjendet në vendin e quajtur “M. Z.”, e evidentuar në Certifikatën me njësi kadastrale P-....-...-4 Z. Kad. M..., të cilat evidentohen pronësi individuale me pjesë të pronës 1/.... si dhe të Detyrohet e paditura që paditësve t’ua kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore aq sa dalin sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, e Pa Bazuar.

II. Detyrohen paditësit që në emër të shpenzimeve të procedurës ti paguajnë të paditurës shumën në lartësi prej 811.20€ në afat prej 15 ditsh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor, ankesë kanë paraqitur paditësit për shkak të: shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që anesa të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

E paditura ka parashtruar përgjigje në ankesë me propozim që të refuzohet ankesa e paditësve si e pa lejuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, si dhe analizimin dhe vlerësimin shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësve është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit N. G., A. G., S. G. dhe R. G., me datën 17.12.2004 në Gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi kundër të Paditurës Komuna e Prishtinës, për shkak të vërtetimit të pronësisë, kërkesë kjo e precizuar në fjalën përfundimtare të deponuar me shkrim e datës 14.12.2021.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësve, ka mbajtur seancën për shqyrtim kryesor, pas dëgjimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin në ankimuar C.nr.3438/2004 të datës 15.12.2021, me të cilin e ka refuzuar kërkesë padinë e paditësve si të pa bazuar, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: për vërtetimin e drejtë dhe të saktë të gjendjes faktike, janë administruar këto prova: fleta poseduese me numër 8 e dt. 18.03.2013; Aktvendimi i Kuvendit Komunal Prishtinë dt. 25.06.1976 të sekretariatit për financiar; Lejimi për përmbarim i dt. 25.06.1967 i lëshuar nga sekretariati i Komunës së Prishtinës; Aktvendimi mbi trashëgiminë LRP/16 dt. 17.06.2016; Aktvendimi T.nr. 130/08 dt. 24.04.2008; Aktvendimi nr. 1486 dt. 27.11.63.i lëshuar nga Komuna e Prishtinës; Vendimi i sekretariatit të punëve të brendshëm me numër të regjistrimitC dt. 22.08.47; Kërkesa me nr. 05-3..... dt. 17.12.2004 drejtuar departamentit për urbanizëm planifikim dhe ndërtim në Komunën e Prishtinës; Mendimi i ekspertit të gjeodezisë dt. 18.08.2008; Konstatimi dhe mendimi i ekspertit A..A. në lëndën C.nr. 730/16 dt. 12.10.2009; Ekspertiza e gjeodezisë e punuar nga eksperti i gjeodezisë Q.. H. e dt.10.09.21.

Më tej ka shtuar se: Në këtë çështje fillimisht është paraqitur padia nga paditësit B. G., S..G., B. G. dhe S. G. të gjithë nga fshati M., të cilët fillimisht pretendojnë se janë pronar faktit të paluajtshmërisë në sipërfaqe proporcionalisht secili aq sa ka përballë shtëpisë së tyre dhe se kjo paluajtshmëri është e paraardhësit të paditësve tani i ndjeri H. G. (U. i cili më vonë sipas për vendimit të datës 22.08.1947 e merr mbiemrin G.) babai i paditësit B. G., R. G.–babai i S. G., Xh. G.-babai i paditësit B. G. dhe Sh. G. babai i S. G., të cilën nga viti 1929 dhe në vijim të viteve tjera e kanë pasur pronë të veten me kulturë arë në sipërfaqe prej 01.75,00 ha e që më vonë e kanë lënë të iu shërbej si kullosë bagëtish. Përmes parashtrësës për precizim të padisë të datës 08.03.2021 i autorizuari i paditësve, tani si palë paditëse ka paraqitur N. G., A. G., S. G dhe R. G. nga fshati M.. komuna e Prishtinës i cili ka bashkangjitur provat mbështetëse për të vërtetuar së të njëjtit janë pasardhësit e paditësve të paraqitur me padinë fillestare edhe atë: për paditësin B. G. është bërë precizimi gjatë seancave është paraqitur Q. G., ndërsa me parashtrësën për precizim është bashkangjitur Aktvendimi LRP.nr. rendor 0.../16 nr. reference 0.../16 me të cilin vërtetohet se një ndër trashëgimtarët e të trashëgimlënësit Q. G. është edhe këtu paditësi A. G., ndërsa përmes Aktvendimit Tnr.1..../08 të Gjykatës Komunale në Prishtinë, vërtetohet se i ndjeri S. G. isha nga Prishtina i cili ka ndërruar jetë me datë 14.01.2008 nga babai R. G., për trashëgimtar i vetëm është shpall, këtu paditësi N. G., për paditësin M. G. ka bashkangjitur kontratën e faljes të lidhur në mes S. G. në cilësinë e dhuratëdhënësit dhe M. G. si dhuratëmarrës, tani paditësi.

Më tej ka shtuar se: Meqenëse kërkesëpadia e paditësve lidhur me këtë çështje ka të bëjë me të drejtën e pronësisë mbi bazën e parashkrimit fitues, gjykata shqyrtoi kushtet ligjore duke iu referuar ligjeve në fuqi që rregullojnë këtë materie. Me dispozitën ligjore nga neni 20 par.1 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore i cili ka qenë në fuqi në kohën e ushtrimit të padisë nga ana e paditësve, në mënyrë decitive parashihet: *“e drejta e pronësisë fitohet sipas vet ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgimi, ndërkaq në paragrafin 2 parashihet: “e drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe mënyrën e caktuar me ligj”* prandaj në këtë rast ashtu siç pretendojnë paditësit edhe nëse paluajtshmërit lëndore në të kaluarën kanë qenë në pronësi të paraardhësve të tyre, të njëjtat me vendim të organit shtetëror janë bart në pronësi të paditurës. Ky fakt është i provuar edhe nga vet paditësit përmes Aktvendimit mbi shpalljen uzurpator të paraardhësit të paditësve R.. (A.) G., nga M., të datës 27.11.1963.

Më tej ka arsyetuar se: Siç rezulton nga shkresat e lëndës, pas kësaj periudhe paraardhësit e paditësve nuk janë pajisur me ndonjë dokument apo ndonjë Aktvendim me të cilin do të vërtetohej se prona i është kthyer atyre, në mënyrë që tani paditësit të argumentojnë të drejtën e fitimit të pronësisë mbi ndonjë bazë të vlefshme ligjore. Nga historiat i elaboruar nga eksperti i gjeodezisë, vërtetohet se ngastrat lëndore evidentohen në regjistra kadastral si pronë shoqërore e Komunës së Prishtinës, të cilat ngastra siç shihet nga vendimet që janë marr lidhur me këto prona, përveç gjendjes juridike janë edhe në shfrytëzim faktit të pronarit, këtu të paditurës Komuna e Prishtinës. Ngastra kad. nr.....-0 dhe 1....-0, Z. kad. M., si tërësi janë formuar në bazë të matjeve aerofotogrametrike të vitit 1972, të cilat kanë hyrë në fuqi në vitin 1980, e të cilat edhe tani janë të aplikueshme. Sipas këtyre matjeve, paditësit gjegjësisht paraardhësit e tyre paluajtshmërinë lëndore nuk e kanë evidentuar në pronësi të veten, kjo vërehet nga gjendja kadastrale në evidencat kadastrale, ndërsa dokumentet e lëshuara nga Republika e Serbisë e të cilat janë cek edhe në ekspertizë, nuk janë lëshuar nga organi kompetent i Republikës së Kosovës dhe si të tilla nuk mund të merren për bazë.

Më tej ka shtuar se: Pavarësisht nga fakti se në të kaluarën e që bëhet fjalë për periudhën e viteve 1929-1934 (ashtu siç është cek në padinë e parashtruar) paraardhësit e paditësve, nuk përjashtohet mundësia të kenë qenë pronar të pronave kontestuese, në situatën ekzistuese është irelevante kjo rrethanë, meqenëse siç u vërtetua e paditura në regjistrat kadastral evidentohet si pronare që nga aeroinqizimi i vitit 1972. Një situatë të tillë e parasheh edhe neni 44 i LMTHJP-së me të cilin është përcaktuar se *“e drejta e pronësisë pushon me kalimin e sendit në pronësi shoqërore”*, që do të thotë se në rastin konkret pronësia e paraardhësve të paditësve ka pushuar që nga momenti kur e njëjta është evidentuar si pronësi shoqërore.

Më tej ka shtuar se: Pretendimet e të autorizuarit të paditësve se janë plotësuar kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së pronësisë së paditësve në paluajtshmërinë lëndore në bazë të parashkrimit fitues janë ta pa bazuara. Pavarësisht se me Ligjin për Ndryshimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (Flet.Zyrt. .../96) është shlyer neni 29 i këtij ligji, i cili parashikonte se nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë në pasuri shoqërore me parashkrim fitues, mirëpo me këtë ligj nuk është parashikuar se ky ndryshim ka ndikim prapaveprues, andaj në rastin konkret afati për parashkrim fillon të rrjedh nga kjo periudhë e deri në momentin e

paraqitjes së padisë në gjykatë me datë 17.12.2004. Rrjedhimisht në bazë të lartcekurave e në kuptim të nenit 28 të LMTHJP me të cilin është përcaktuar “*se mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrim fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh*” kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk janë përmbushur kushtet ligjore për të fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues, pasi që nuk ka kaluar afati kohor i paraparë me këtë dispozitë ligjore sepse që nga koha e aplikimit të kësaj dispozite viti 1996 e deri ne paraqitjen e padisë në gjykatë datë 17.12.2004 kanë kaluar 8 vite, që do të thotë se nuk është përmbushur kushti thelbësor i kalimit të afatit prej 20 vitesh.

Vendimi mbi shpenzimet është marr në kuptim të nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, nisur nga kjo gjendje e kësaj çështje, vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, ngase Aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe neni 182.2 pika n), lidhur me nenin 160 par. 3 dhe 4 të LPK-së, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i pa kuart dhe i pakuptueshëm, për të njëjtin mungojnë arsyet për faktet vendimtare, në ndërkohë që edhe ato arsye të cilat janë dhënë, janë në kundërshtim me vetë dispozitivin dhe provat shkresore të lëndës. Si rezultat i kësaj edhe gjendja faktike në këtë procedurë nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për të cilën arsye pastaj ka ardhur edhe deri te zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Gjykata e Apelit aprovon si të bazuara pretendimet ankimore të paditësve në lidhje me shkeljet thelbësore nga 182.2 pika n), lidhur me nenin 160 të LPK-së, kjo për faktin se Gjykata e shkallës, së parë me aktgjykimin e ankimuar nuk ju ka përmbajtur dispozitave të cekura më lartë pasi që i njëjti është kontradiktor me vetveten përkatësisht në pjesën hyrëse dhe të dispozitivit pasi që gjykata e shkallës së parë në pjesën hyrëse të aktgjykimit ka evidentuar katër paditës dhe atë N. G., A. G., S. G. dhe R. G., që të gjithë nga fshati M., komuna e Prishtinës, ndërsa në dispozitiv ka vendosur për N. G., A. G., S. G., m. G. dhe R. G., që të gjithë nga fshati M., komuna e Prishtinës e që e njëjta, gjykata e shkallës së parë është dashur të sqarojë faktin se personi M. G. a është palë në procedurë pasi që në hyrje të aktgjykimit nuk figuron fare e gjithashtu gjykata e shkallës së parë në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar ka vendosur për një parcelë dhe atë 484-0 e që fare nuk bënë pjesë në kërkesën e palëve.

Gjithashtu gjykata e apelit thekson se siç del nga shkresat e lëndës paditësit me padi kanë kërkuar që të vërtetohet se janë pronar të pjesëve përballë truallit të tyre dhe atë parcelat me nr., -1, ...-2 si dhe-3, e që paditësit kërkojnë një pjesë të këtyre sipërfaqeve, ndërsa paditësi N. G. ka kërkuar vërtetimin e pronësisë në parcelat me nr. -1, në sipërfaqe prej ...m², parcela me nr. ...-2 në sipërfaqe prej ...m², parcela nr.....3 në sipërfaqe prej m² si dhe parcela me nr.-4 në sipërfaqe prej ... m², për të cilët paditësit pretendojnë që kanë hyrë në posedim. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur që ta refuzoi kërkesëpadinë e paditësit por pa përcaktuar masat dhe kufijtë e këtyre ngastrave kadastrale dhe pa u përcaktuar as në cilën anë të ngastrave të lartë cekura gjendet kjo pjesë e që në këtë kuptim dispozitivi i aktgjykimit është tejet i pa kuart.

Përveç të metave të dispozitivit të aktgjykimit të cekura më lartë këto pjesë kontestuese as nuk është përshkruar se në cilën ngastëra kadastrale shtrihet. A shtrihet në ngastrën kadastrale, 4.-1,..-2 si dhe-3, pasi që formulimi logjik në dispozitiv është përcaktuar se kërkohet vërtetimi i prtonësisë përball pllaceve të tyre dhe nuk është përcaktuar se sa është sipërfaqja për secilin paditës që kërkojnë vërtetimin e pronësisë dhe kjo sipërfaqe cilës parcelë i takon. Pavarësisht faktit se kërkesëpadia e paditësve është refuzuar dispozitivi i aktgjykimit duhet të jetë i qartë i kuptueshëm në mënyrë që më pastaj çështja e vendosur të bëhet e gjykuar.

Nga mënyra se si ka vendosur gjykata e shkallës së parë si dhe nga paqartësitë e dispozitivit të aktgjykimit pa u përcaktuar pjesët konkretisht me masa dhe kufij të ngastrës kontestuese si dhe pa u përcaktuar se në cilat ngastra shtrihet pjesët e parcelave në sipërfaqe të cekur si më lartë, përkatësisht në cilën pjesë të këtyre ngastrave (të përcaktohet gjatësia dhe gjerësia si dhe ana se nga shtrihet pjesa kontestuese) atëherë edhe çështja nuk mund të thuhet se është e gjykuar.

Në situatën e tillë gjykata e shkallës së parë, pas pranimit të ekspertizës së gjeodezisë dhe plotësim ekspertizës së gjeodezisë në të cilën janë specifikuar edhe dimensionet e parcelave kontestuese, është dashur të veprojnë në kuptim të dispozitave të ligjit për procedurën kontestimore nga neni 99 parag.2 lidhur me nenin 102, duke ia kthyer në plotësim padinë paditësit. Ashtu që ai ta precizojnë saktë kërkesëpadinë së pari në cilën ngastër shtrihet pjesa kontestuese. Më pastaj në cilën pjesë të ngastrave shtrihet kjo pjesë prej... m2 e cila paraqitet si kontestuese të përcaktohet saktësisht masat dhe kufijtë e kësaj pjese në mënyrë që kur të vendos gjykata e shkallës së parë dispozitiv i saj të jetë i qartë dhe i kuptueshëm e gjithashtu të kërkojë nga paditësit të precizojnë saktë se cilët janë palët në këtë procedurë në anën e paditësve, pasi që sipas aktgjykimit të shkallës së parë, është e pa kuartë se cilët janë në të vërtetë paditësit. Andaj, Gjukata e shkallës së parë është dashur që të veprojnë në kuptim të nenit 99 parag.2 lidhur e nenin 102 të LPK-së.

Nga mos ndërmarrja e veprimeve të nevojshëm procedurale gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 parag.1 dhe 182 parag.2 pika n) të LPK-së. Kjo për faktin se ajo nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të lartë cekura dhe si përfundim dispozitivi i aktgjykimit të saj është i pa kuptueshëm pasi që nuk dihet se për cilën pjesë të parcelave ka vendosur gjykata e shkallës së parë.

Udhëzohet, gjykata e shkallës së parë, që në ri procedurë ti evitojë të metat e theksuara më lartë. Për ta bërë të qartë, kuptueshëm dhe të përmbarueshëm dispozitivin e aktgjykimit ajo fillimisht duhet ti kthejë në plotësi padinë dhe kërkesë padinë paditësve me qëllim që të rregullohet e njëjta në aspektin subjektiv dhe objektiv duke përcaktuar se kush janë paditësit dhe për secilin paditës të përcaktojë se cila është kërkesa e tyre. Duhet të precizohen edhe masat dhe kufijtë e pjesëve kontestuese për secilën ngastër (ku shtrihen sipërfaqet e kërkuara, gjatësi dhe gjerësi), për këtë gjykata e shkallës së parë duhet ta zbatoj dispozitivin e nenit 99 parag.2 lidhur me nenin 102 të LPK-së duke ia kthyer në plotësim padinë paditësit. Nëse kjo nuk është e mundur në bazë të ekspertizës së gjeodezisë dhe plotësim ekspertizës së gjeodezisë, ta ftoj ekspertin e gjeodezisë për ta plotësuar ekspertizën e tij ashtu që ai sipërfaqes kontestuese të cekura më lartë të ia caktoj masat dhe kufijtë (gjatësinë, gjerësinë dhe shtrirjen e tyre), ti administrojë edhe provat tjera dhe të vendos për kërkesëpadinë e paditësit në bazë të ligjit.

Numri i lëndës: 2019:282505
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05488962

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 pika c), të LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AC.nr.1335/2022, me datë 21.03.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari

Besnik Bislimaj, d.v